

Aneks nr...

Për punonjësit me kontratë të përkohshme

Për kontraktimin e punonjësve me kohë të pjesshme mbi numrin organik të punonjësve të institucioneve buxhetore për vitin 2022, ndiqen këto rregulla:

1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme miratohet nga Këshilli i Ministrave nëpërmjet propozimit të Ministrit përgjegjës për Financat.
2. Institucioni duhet të ketë fondet e nevojshme për mbulimin e shpenzimeve të personelit të kontraktuar.
3. Veprimtaria që kryejnë punonjësit me kontratë është kryesisht veprimtari e njësive strukturore mbështetëse/rregullatore/shërbimi të institucionit dhe në asnjë rast veprimtari e njësive strukturore politikë-bërëse, inspektuese apo audituese.
4. Kontraktimi i punonjësve bëhet në përputhje me kriteret e parashikuara për atë pozicion pune, për një periudhë kohore deri në 6 muaj gjatë një viti buxhetor me kohë pune ditore të plotë, ose deri në 6 orë në ditë përgjatë vitit buxhetor. Përgjatë nga ky përcaktim, bën kontraktimi i punonjësve që kryejnë një veprimtari që realizon të ardhura dytësore, përdorimi i të cilave parashikohet në ligjin vjetor të buxhetit, për këtë qëllim.
5. Pagesa e punonjësve me kontratë të përkohshme, përcaktohet në referencë të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, për pozicionin për të cilin ai kontraktohet. Për pozicionin “Specialist”, paga e punonjësit me kontratë të përkohshme në institucionet e pavarura dhe aparatet e ministrive nuk kalon nivelin e kategorisë IV-a dhe në institucionet në varësi të tyre, nivelin e kategorisë IV-b. Në rast se pozicioni “specialist” ka shtesa specifike mbi pagën e kategorisë përkatëse, ato nuk përfitohen nga punonjësi me kontratë të përkohshme.
6. Pagesa bëhet në përputhje me procedurat e kryerjes së pagesave për punonjësit organik dhe përfshihet në shpenzimet e personelit të institucionit. Përgjatë nga ky rregull, bëjnë anketuesit/kontrollorët e terrenit të kontraktuar në realizimin e Census-it dhe anketimeve afatshkurta (më pak se dy javë), pagesa e të cilëve e bazuar në ditët e punës, do të përfshihet në shpenzimet operative të institucionit.
7. Në raste specifike që lidhen me mësimdhënien, veprimtarinë bujqësore, veprimtarinë statistikore, rregullat dhe procedurat e marrjes në punë të punonjësve me kontratë përcaktohen nëpërmjet udhëzimit të përbashkët të miratuar mes institucionit qendror përgjegjës dhe Ministrisë përgjegjëse për Financat.